



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:112403
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05453864

CN.nr.248/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm gjyqtari Shaban Shala, në kontestin e propozueses T.V. me vendbanim në Prishtinë, ndaj kundër propozuesve M. dhe A.V. nga Prizreni, për shkak të propozimit për ndarje fizike, më datën 14.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET SI E PA LEJUSHËM propozimi në këtë çështje juridike jo kontestimore për shkak të gjyqvarsisë (litispendenca).

II. Me shpenzimet e procedurës obligohet propozuesi.

A r s y e t i m

Propozuesja T.V. me vendbanim në Prishtinë, në këtë gjykatë ndaj kundër propozuesve M. dhe A.V. nga Prizreni, ka parashtruar propozim për ndarje fizike,

Duke vepruar sipas detyrës zyrtare gjykata ka siguruar provat: propozimin për ndarje fizike i cili evidentohet si CN.nr.314/17 dt.05.05.2017 dhe fotokopjen e certifikatës së pronësisë lidhur më ngastrën kadastrale 4539-0 ZK Prizren e cila është objekt ndarje fizike sipas të cilave vërtetohet fakti se në këtë gjykatë zhvillohet edhe një propozim tjetër për ndarje fizike ndërmjet palëve të njëjta dhe me lëndë të njëjtë të ndarjes fizike.

Nga këto të dhëna gjykata ka vërtetuar faktin se në rastin konkret ekziston gjyqvarësia (Litispendenca) për shkak se palë dhe lënda e propozimit është identike me lëndën CN.nr.314/2017 e cila është duke u zhvilluar në këtë gjykatë i cili fakt vërtetohet nga shkresat e kësaj lënde, andaj duke u bazuar në nenin 391 par.1 pika c të LPK-së të cilat në këtë rast zbatohen përshtatshmërisht gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e hedhur

Numri i lëndës: 2019:112403

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05453864

propozimin si të palejuesëm për shkak se ekziston gjyqvarësia respektivisht për një lëndë janë duke u zhvilluar dy procedura.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

-Departamenti i përgjithshëm-

CN.nr.248/19, datë 14.03.2024

Sekretare Juridike,

Feriha Brando

Gjyqtari,

Shaban Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.